ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna e Prishtins - Sektori i Prokurimit**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**205-24-4174-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit me titull: **"Intervenime Infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona, në tërë territorin e Komunës së Prishtinës" - LOT 6**

ANKESË

Emri i plotë i kompanisë:	**OE EL BAU Sh.p.k..**
Adresa:	Rr. Nato 99
Vendi:	Gjilan
Kodi postar:	60000
Numri Telefonit:	049 24 43 30
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:	Fatlum Pireva
Adresa elektronike:	shpkelbau@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	09 shtator 2024
Nënshkrimi dhe vula:	

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

1. *Publikimi i Njoftimit për kontratë me datë 27.05.2024*
2. *Procedurë e hapur*
3. *Lloji i kontratës – Kontratë Publike Kornizë - Punë*
4. *Vlera e parashikuar 1,400,000.00 (Lot VI)*
5. *Kriteri për dhënien e kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët*
6. *Afati i fundit per dorezimin e tenderit me dt. 03.06.2024, ora 13:30;*
7. *Njoftim mbi Vendimin e AK-se i dt. 20.08.2024*
8. *Kërkesa për Rishqyrtim, dt. 26.08.2024*
9. *Vendimi i AK-es me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE ankues, i publikuar në e-prokurimi me datë 29.08.2024*
10. *Me datë 09.09.2024 (afati i fundit në ditë vikendi, e diel) parashtrojmë ankesë në OSHP*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është zhvilluar përmes platformës e-prokurimi pa praninë e përfaqësuesve të OE pjesëmarrës

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Me datën 26.08.2024, OE "El-Bau" Sh.p.k. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Komunës së Prishtinës, me të cilën ka atakuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së për dhënien e kontratës, letrat standarde për tenderuesit e pasuksessshëm që janë radhitur sipas çmimit para OE ankues si dhe kundër letrës standarde përkitazi me tenderin/ofertën e OE ankues. Në kërkesë janë parashtruar fakte relevante dhe të argumentuara me prova konkrete për secilin pretendim që është ngritur, e të cilat konfirmojnë shkeljet thelbësore të AK-së, për faktin se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave për LOT 6 është bërë në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit që garantohen me nenin 1 dhe 7 të LPP-së dhe njëkohësisht në kundërshtim me kriteret ligjore të vlerësimit që i përcaktojnë dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Duke u bazuar në analizimin e përgjithshëm të dosjeve dhe dokumenteve të tenderit me të cilat kanë ofertuar për LOT 6 operatorët ekonomik si në vijim: GOE "Company Eskavatori Sh.p.k. & Beni Construction Sh.p.k." (i shpallur fitues); OE "K.N.PSH. Papenburg & Adriany Company"; "GOE "Rexha & Qëndresa Sh.p.k."; GOE "ED Construction Sh.p.k & RSM Company"' GOE "Agim Morina B.I. & Arbër1-NS Sh.p.k."; OE "Alfa 1 Sh.p.k."; OE "Rea Sh.p.k." GOE "Haxha Com & KNTSH World Medium"; GOE "Vëllezërit Hysa Sh.p.k. & Conex L.L.C. &Domid Sh.p.k. & Dardaniaa Sh.p.k. & Arda Group Construction"; GOE "Korabi & NNT Ndertimi & Burimi E Sh.p.k.; GOE "Gërlica Company & IPN Group Sh.p.k." OE "Toifor Sh.p.k."; OE "ARFA Group", kemi gjetur se ofertat/tenderët e secilit prej OE dhe/ose GOE nuk janë në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Në bazë të dispozitës së nenit 59.4 të LPP-së dhe nenit 40.6 i RRPP Nr.001/2022, një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse i përmbush të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe njoftimin e kontratës. Në këtë kontekst, faktet dhe të gjeturat që mund të verifikohen lehtësisht nga dokumentacioni i prokurimit, vërtetojnë se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në përputhje me kriteret ligjore të dispozitave përkatëse, nenit 59.4 dhe nenin 69.4 të LPP-së dhe nenin 40 par. 1,6 dhe 13 të RRPP Nr.001/2022, si kusht qenësor e përcakton se, tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.

Prandaj duke i marrë në konsideratë sqarimet e lartcekura, ne si OE ankues konsiderojmë se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në shkele thelbësore të dispozitave si më poshtë:

- Neni 1 në paragrafin 1 dhe 2 i LPP-së lidhur me nenin 4.3 i RRPP;

- Nenin 7 në paragrafin 1, 2 dhe 6 pika vi) i LPP lidhur me nenin 4.3 (c) i RRPP Nr. 001/2022
- Neni 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i LPP-së;
- Neni 59 në paragrafin 4 i LPP-së i lidhur me nenin 40 paragrafi 1, 2, 6 dhe 13 të RRPP Nr. 001/2022;
- Neni 69 në paragrafin 1 lidhur me paragrafin 4 nënparagrafin 5 të LPP
- Neni 108/A në paragrafin 12 të LPP-së
- Neni 48 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administative.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Rrethanat e procesit të aktivitetit në fjalë.

1. Me datën 03.06.2024, parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim OE "EL-BAU" Sh.p.k. si grup së bashku me OE "Eing Com Sh.p.k."ka paraqitur tenderin dhe ofertën lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Intervenime Infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona, në tërë territorin e Komunës së Prishtinës" - LOT 6, , të inicuar nga AK- Komuna e Prishtinës. Ashtu që, në relacion me GOE të shpërblyer me kontratë dhe ofertuesit tjerë që janë radhitur me çmim më të lirë para ankuesit, tenderi/oferta jonë është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, përkatësisht të gjitha kriteret kualifikuese, dhe kriterin vlerësues për dhënien e kontratës "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" dhe njëkohësisht në përputhje me nenin 59.4 dhe nenin 60 paragrafi 1.2 të LPP-së si ligj material i zbatueshëm.

2. Por, pavarësisht kësaj situate e cila mund të verifikohet nga dokumentacioni i prokurimit me të cilin OE ankues ka ofertuar, AK, respektuivisht Komisioni Vlerësues nuk e ka kryer procesin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave në përputhje me kriteret që vet i ka përcaktuar në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe as në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP, konkretisht nenit 59.4, nenit 60 par.1.2 të LPP-së ndërlidhur me nenin 40 par.1,2,6 dhe 13 të RRPP, përfshirë edhe nenin 1,6 dhe 7 të LPP-së, për faktin se ka shpërblyer me kontratë GOE "Company Eskavatori Sh.p.k. & Beni Construction Sh.p.k." tenderi i të cilit nuk është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat kualifikuese të dosjes së tenderit dhe krahas kësaj ka vlerësuar si të përgjegjshëm/pasuksesshëm OE dhe/ose GOE që nuk janë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit, e të

cilët janë si në vijim: OE "K.N.PSH. Papenburg & Adriany Company"; "GOE "Rexha & Qëndresa Sh.p.k."; GOE "ED Construction Sh.p.k & RSM Company"' GOE "Agim Morina B.I. & Arbër1-NS Sh.p.k."; OE "Alfa 1 Sh.p.k."; OE "Rea Sh.p.k." GOE "Haxha Com & KNTSH World Medium"; GOE "Vëllezërit Hysa Sh.p.k. & Conex L.L.C. &Domid Sh.p.k. & Dardaniaa Sh.p.k. & Arda Group Construction"; GOE "Korabi & NNT Ndertimi & Burimi E Sh.p.k.GOE "Gërlica Company & IPN Group Sh.p.k." OE "Toifor Sh.p.k."; OE "Arfa Group"

3. Lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim, AK-ja Komuna me datën 29.08.2024 ka marr vendim përmes të cilit ka vendosur që kërkesën e OE ankues El-Bau Sh.p.k. ta refuzojë si të pabazuar me një arsyetim të përgjithësuar të cilit i mungon analiza e argumenteve në raport me kundërshtimin e pretendimeve ankimore të kërkesës, rrjedhimisht arsyetimi i theksuar në vendim nuk është i bazuar në asnjë fakt të provuar dhe në asnjë dispozitë ligjore të LPP-së dhe RRPP.

4. Prandaj, duke qenë se nga ana e AK-së edhe gjatë procesit paraprak për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nuk janë ndërmarrë veprime që kanë për qëllim korrigjimin e akteve dhe veprimeve të kundërligjshme që ndërlidhen me vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve dhe marrjen e njoftim mbi vendimin e AK-së, dhe njëkohësisht duke qenë se ky vendim ka cenuar të drejtat dhe interesat tona ligjore në raport me interesin material nga kjo kontratë, OE ankues detyrohet t'i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë të bazuar/mbështetur në fakte dhe prova të argumentuara për secilën shkelje të pretenduar, në mënyrë që të njejtat të vlerësohen dhe shqyrtohen nga eksperti shqyrtues/paneli shqyrtues në mënyrë profesionale dhe meritore si dhe në pajtueshmëri me këtë ligj.

2. Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimi ankimor kundër vendimit i datës 29.08.2024 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues "El-Bau" si të pabazuar.

Nga ana e Sektorit të Prokurimit të MMPHI, përmes vendimit të publikuar me datë 29.08.2024 është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga OE El-Bau Sh.p.k. me një arsyetim të përgjithësuar, pa arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare dhe të paargumentuar me asnjë fakt dhe provë konkrete, e gjithashtu pa mbështetje në dispozitat ligjore të zbatueshme në rastin konkret sipas LPP-së si ligj material dhe RRPP. Nga arsyetimi i përgjithësuar i këtij vendimi shihet qartë se nga ana e AK-së nuk janë marrë parasysh por janë injoruar në tërësi të gjitha argumentet mbështetura në fakte dhe prova konkrete të përfshira në pretendimet ankimore të kërkesës që kundërshtojnë eliminimin e vet ankuesit dhe njëkohësisht kundërshtimet ndaj GOE të rekomanduar si dhe ndaj OE&GOE të cilët janë vlerësuar të pasuksesshëm dhe kanë çmimin më të lirë se sa ankuesi dhe pastaj mbrojtjen, të cilat lehëstisht kanë mundur të vërtetohen nga dokumentacionit i prokurimit.

Përsa i përket GOE të rekomanduar me kontratë, sqarojmë:

Duke u bazuar në dosjen dhe dokumentet me të cilat GOE i rekomanduar ka ofertuar në këtë aktivitet, kemi paraqitur gjetjet që argumentohen me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se tenderi/oferta e GOE të rekomanduar nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kjo për faktin se nuk i ka përmbushur kërkesat për kualifikim sikurse vijon: **1)** kërkesën e kapacitetit teknik, pika 9.1&92 të FTD lidhur me kërkesën për pajisjen "**mjet ngritës me pirun**", ku thuhet se për automjetet që regjistrohen operatori ekonomik duhet të paraqes librezën e qarkulimit me validitet. Kurse GOE i rekomanduar për të plotësuar këtë kërkesë ka paraqitur si dëshmi dokumentin DUD i cili nuk e përmbush kërkesën e DT për faktin se "**mjet ngritës me pirun**", klasifikohet si mjet i cili merr pjesë në qarkullim rrugor dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollimit teknik vjetor dhe të regjistrohet siç kërkohet me Ligjin Nr. 05/L-132 (shih nenin 76, etj) dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2018 për Regjistrimin e Mjeteve. **2)** kërkesën për "ISO 9001 2015 AKREDITUAR" e cila i përket çertifikatave për sigurimin e cilësisë të cilat përmenden në nenin 70 të LPP dhe nenin 26.6 të RRPP, për faktin se OE BeniConstruction Sh.p.k." në cilësinë e anëtarit të GOE nuk e ka përmbushur kërkesën e standardeve përkatëse pasi që nuk ka ofruar dëshmi të çertifikatës "ISO 9001 2015 AKREDITUAR". Lidhur me çertifikatat për sigurimin e cilësisë të cilat përmenden në nenin 70 të LPP, dispozita adekuate e nenit 26 e RRPP nr.001/2022 ka rregulluar situatat e tilla se si të dëshmohen dhe përmbushen standardet e tilla kur një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, ashtu që në paragrafin 6 ka përcaktuar, po e citoj: *"Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare,* ***secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.".***

Sa i përket pretendimit të parashtruar lidhur me mos përmbushjen e kërkesën për pajisjen "mjet ngritës me pirun", në vendimin për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim, AK e ka injoruar në tërësi këtë pretendim duke mos e shqyrtuar fare, rrjedhimisht nuk e ka shpjeguar arsyetimin e situatës faktike, bazën ligjore dhe shkaqet se pse është refuzuar ky pretendim konkret ankimor, edhe pse AK-ja është dashur që të paraqet një arsyetim të plotë dhe të qartë në vendimin e marr konform nenit 108/A paragrafit 12 të LPP-së

Sa i përket pretendimit të parashtruar lidhur me mos përmbushjen e kërkesës "ISO 9001 2015 AKREDITUAR" nga anëtari i grupit të rekomanduar OE Beni Construction Sh.p.k.", e cila i përket çertifikatave për sigurimin e cilësisë të cilat përmenden në nenin 70 të LPP, në vendimin për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim, AK-ja duke e ngatërruar/keqinterpreruar përshkrimin ligjor të dispozitës të nenit 69 të LPP-së në raport me nenin 71 të LPP-së dhe nenin

26.6 të RRPP, ka paraqit përshkrim të gabuar të gjendjes faktike, duke theksuar se kërkesa për "ISO 9001 2015 AKREDITUAR" është kërkesë teknike dhe profesionale në kuptim të nenit 69 të LPP-së dhe se aplikohet vetëm ndaj grupit në tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Pra, vet ky konstatim vërteton se AK-ja ka zbatim jo të drejtë të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 26.6 të RRPP dhe interpretim përtej tekstit dhe qëllimit të tyre, që për pasojë ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të atakuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme, me të cilin ankuesit i është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim.

Nisur nga fakti se:

Çertifikat për sigurimin e cilësisë me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të të caktuar standardesh të sigurisë (standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare), ato janë të parashikuara dhe rregulluara me nenin 70 të LPP. Dhe pavarësisht se në cilën pjesë të dosjes vendosen ato nuk mund të mbizotërojnë dispozitat përkatëse ligjore, andaj, kur një tender dorëzohet nga një grup i operatoëreve ekonomik, kërkohet që secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse, që nënkupton se aplikohen për secilin anëtar individualisht dhe jo ndaj grupit si tërësi.

Kualifikimet e kapacitetit teknik dhe profesional janë të parashikuara dhe rregulluara me nenin 69 të LPP-së që aplikohen ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve infividual të grupit, bazohen në: raportin mbi fuqinë mesatare të punëtorëe dhe personelit udhëheqës që duhet të plotësohen me dëshmitë mbi kualifikimet shkollore dhe profesionale të tyre; listën e kontratave të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare të cilat duhet të plotësohen me dëshmitë përkatëse; raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës të cilat duhet të plotësohen me dëshmitë përkatëse.

Pra, nga ky aspekt krahasimor i përmbajtjes tekstuale të dispozitës së nenit 70 në raport me nenin 69 të LPP-së, shihet qartë se çertifikatat për sigurimin e cilësisë me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të të caktuar standardesh të sigurisë (standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare), nuk janë kërkesa sipas neneve 66.1, 68 dhe 69 të LPP-së që me dispozitën e nenit 71 është e përcaktuar dhe rregulluar se aplikohen ndaj grupit si tërësi. Por janë kërkesa të tilla që aplikohen për secilin anëtar individualisht ashtu siç është parashikuar dhe përcaktuar me paragrafin 6 të nenit 26 të RRPP nr. 001/2022.

Kjo çështje si e tillw qëndron në konsistencwn e vendimeve tw OSHP, si psh vendimi PSH.nr.45/23

Si përfundim, duke ju referuar kësaj gjendje faktike, rezulton se GOE i rekomanduar me kontratë nuk e ka përmbushur kërkesën **për pajisjen "mjet ngritës me pirun"**

dhe kërkesën për "ISO 9001 2015 AKREDITUAR", dhe konform dispozitave ligjore të lartcekura dhe nenit 59.4 të LPP-së do të duhej të eliminohej nga procesi i prokurimit. Prandaj, situata e cekur e vërteton se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, dhe se është vendosur në favor të GOE te rekomanduar, respektivisht në dëm të OE ankues, si pasojë e zbatimit të gabuar dhe përtej tekstit dhe qëllimit të saj dispozitën e nenit 69, nenit 70 të LPP-së dhe nenit 26.6 të RRPP nr. 001/2022.

Përsa i përket OE tjerë të cilët janë të pasukseshëm dhe kanë çmimin më të lirë se sa ankuesi, sqarojmë:

Duke u bazuar në dosjen dhe dokumentet me të cilat kanë ofertuar OE apo GOE e pasuksesshëm që kanë çmimin më të lirë se sa ankuesi (*OE "K.N.PSH. Papenburg & Adriany Company"; "GOE "Rexha & Qëndresa Sh.p.k."; GOE "ED Construction Sh.p.k & RSM Company"' GOE "Agim Morina B.I. & Arbër1-NS Sh.p.k."; OE "Alfa 1 Sh.p.k."; OE "Rea Sh.p.k." GOE "Haxha Com & KNTSH Ëorld Medium"; GOE "Vëllezërit Hysa Sh.p.k. & Conex L.L.C. &Domid Sh.p.k. & Dardaniaa Sh.p.k. & Arda Group Construction"; GOE "Korabi & NNT Ndertimi & Burimi E Sh.p.k.GOE "Gërlica Company & IPN Group Sh.p.k." GOE ALKO-IMPEX General Construction & Mardem Group Sh.p.k; OE "Toifor Sh.p.k."; OE "Arfa Group"*) në kërkesë kemi paraqitur gjetjet që argumentohen me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se tenderi/oferta e secilit prej tyre nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Për faktin se tenderët dhe dokumentet e ofruara për secilin nga OE apo GOE e lartcekur nuk e përmbushin: **1)** kërkesën për pajisjen "mjet ngritës me pirun", pasi që nuk kanë ofruar librezë të qarkullimit me validitet por vetëm DUD (dokument unik doganor), përjashtimisht *OE Toifor Sh.p.k.; GOE "Rexha & Qëndresa Sh.p.k; GOE Korabi & NNT Ndertimi & Burimi E Sh.p.k.; OE Alfa 1 Sh.p.k si dhe GOE ALKO-IMPEX General Construction & Mardem Group Sh.p.k* nuk kanë ofruar asnjë dëshmi, pavarësisht se ky mjet në rastin konkret sipas zërave të kontratës përdoret në rrugë publike dhe si i tillë duhet të plotësojë kushtet e trafikut rrugor, të cilat përfshijnë, regjistrimin, sigurimin dhe kontrllën teknike, dhe **2)** operatorët ekonomik që kanë ofertuar si grup i operatorëve ekonomik nuk e kanë plotësuar kërkesën për "ISO 9001 2015 AKREDITUAR" e cila i përket çertifikatave për sigurimin e cilësisë të cilat përmenden në nenin 70 të LPP, pasi që nuk kanë ofruar çertifikatë të tillë për secilin anëtar të grupit, pavarësisht se kjo kërkesë aplikohet për secilin anëtar individualisht ashtu siç është parashikuar dhe përcaktuar me paragrafin 6 të nenit 26 të RRPP nr. 001/2022. **Shihni ju lutem përshkrimin e tërësishëm dhe detajuar për secilin pretendim në pjesën e përkatëse të ankesës si vijon më poshtë.**

Sa i përket pretendimeve në fjalë ndaj OE tjerë të cilët janë të pasukseshëm dhe kanë çmimin më të lirë se sa ankuesi, në vendimin për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim, AK-ja nuk ka bërë një vlerësim konkret dhe nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë arsyetimet lidhur me pretendimet e ngritura

nga OE ankues në kërkesën për rishqyrtim edhe pse është dashur që të paraqet një arsyetim të plotë dhe të qartë përkitazi me çështjet e ngritura në vendimin e marr. Por duke i injoruar në tërësi faktet dhe provat e paraqitura nga ankuesi në raport me OE ose GOE të pasuksesshëm që kanë çmim më të lirë se sa ankuesi, si dhe duke e ngatërruar gjendjen faktike dhe zbatuar gabimisht (keqinterpretuar) nenin 4.1.26 të LPP-së përtej tekstit dhe kushteve të tij, ka konstatuar se kinse OE ankues nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së, pa dhënë asnjë shpjegim konkret dhe të argumentuar se në cilat shkaqe apo fakte e bazon pretendimin e lartcekur. Duke qënë se nga ana e OE ankues janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e dispozitës së nenit 4 parag.1 nënaparagrafi 26 i LPP-së duke marrë në konsideratë edhe konsistencën e vendimeve të OSHP për këtë çështje, si në vijim: **a)** OE ankues është i pasuksesshëm dhe ka paraqitur pretendime ankimore që synojnë të kundërshtojnë eliminimin e ofertës së tij, **b)** OE ankues ka paraqitur pretendime ankimore të konkretizuara ndaj GOE të rekomanduar dhe ndaj secilit OE ose GOE të cilët janë të pasukseshëm dhe kanë çmimin më të lirë se sa ankuesi. Kursa nga ana tjetër, OE ankues ka paraqitur konstatimet e konkretizuara ndaj OE të cilët kanë qenë të eliminuar dhe ndaj OE/GOE të cilët janë pajtuar me vendimin dhe me vlerësimin e tenderit për eliminimin e tij për këtë aktivitet të prokurimit.

Pra, vetë kjo gjendje faktike e vërteton se AK-ja si inicues i vazhueshëm në fushën e aktiviteteve të prokurimit ka qenë e vetëdijshme dhe e ka pasur të qartë që OE ankues i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të kualifikimit si palë me interes në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së dhe konsistencës së vendimeve të OSHP-së për këtë çështje.

Prandaj, situata e cekur e vërteton se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, pasi që i ka ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar ofertat në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operator ekonomik" si dhe në kundërshtim me nenin 59 par. 4 LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmërinë me të gjitha gjërat e parashtruara në njoftimin e kontratave dhe në dosjet e tenderit", duke mos ju përmbajtur kritereve juridike të kërkesave të parashtruara në njoftimin per kontratat dhe dosjen e tenderit, dhe duke mos respektuar kriteret e dhënies, tenderin e përgjegjshëm me çmimin ekonomikisht më i favorshëm.

Kjo si rrjedhojë ka sjell situatën juridike në dëm të OE ankues i cili në këto rrethana mund të jetë fitues i tenderit për LOT 6 duke qenë se është i vetmi OE që ka paraqitur ofertën/tenderin e përgjegjshëm me çmimin ekonomikisht më i favorshëm për LOT 6 në përputhje me kërkesat e vendosura nga AK në dosjen e tenderit dhe në pajtim me dispozitat ligjore të LPP dhe RRPP që parashohin dhe

përcaktojnë kriteret e vlerësimit të tenderëve. Prandaj, ky vendim i kundërligjshëm nuk e pasqyron zgjidhjen e drejtë, të barabartë dhe të ligjshme të lëndës në relacion me gjendjen e plotë faktiko-juridike, rrjedhimisht me kërkesat e dosjes së tenderit dhe bazës ligjore të zbatueshme, LPP dhe RRPP.

Në vijim gjeni pretendimet ankimore të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues përmes kërkesës për rishqyrtim të dt. 26.08.2024

Duke u nisur nga gjendja faktike dhe juridike e paraqitur si më lart, e theksojmë edhe një herë se AK-ja, respektivisht komisioni i vlerësimit gjatë procesit të ekzaminimit,vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve për LOT 6 nuk i ka respektuar kriteret që vet i ka përcaktuar në DT dhe NJK, respektivisht nuk e ka respektuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë nenin 59 paragrafin 4 të LPP-së, ku shkruan se: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*. Pastaj nuk e ka respektuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë nenin 40 të RRPP që shkruan se: **paragrafi 1 lidhur me paragrafin 13** *"Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP, AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.;* **paragrafi 2** *Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit;* **paragrafin 6** *Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:* ***a.*** *është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;* ***b.*** *është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;* ***c.*** *është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.* Dhe njëkohësisht nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë kriteri për dhënien e kontratës "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" siç përcaktohet me nenin 60 - Kriterin e dhënies së kontratës në paragrafin 1.2 ku thuhet *"tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji"* përfshirë dispozitat tjera relevante.

Kjo gjendje faktike konfirmohet dhe vërtetohet në bazë të fakteve dhe provave përmes dokumenteve të dosjes së tenderit me të cilat ka ofertuar GOE në fjalë dhe që paraqiten si më poshtë:

Pretendimi lidhur me GOE "Company Eskavatori&Beni Construction Sh.p.k." i shpallur fitues për lot 6

Në bazë të Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të dt. 20.08.2024, AK e ka shpërblyer me dhënie të kontratës për LOT 6, GOE "Company Eskavatori&Beni Construction Sh.p.k." në vlerën prej 980,010.00€.

Bazuar në analizimin e hollësishëm të dosjes dhe dokumenteve me të cilat GOE në fjalë ka ofertuar në këtë aktivitet për lotin e lartcekur, e të cilat i kemi siguruar nga qasja zyrtare (formë elektronike) në dosjen e tij , kemi gjetur se tenderi/oferta e tij nuk është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat kualifikuese të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, i cili është kusht qenësor që

përcakton se, tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.

Konkretisht nga ana e anëtarit të GOE "Beni Construction Sh.p.k." nuk është plotësuar konform dosjes së tenderit kërkesa lidhur me Çertfikaten per ISO 9001 2015, ku në mënyrë taksative kërkohet që "**OE duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015 AKREDITUAR**", dëshmia e kërkuar dokumentare: "Certfikate e ISO 9001 2015 te noterizuara nga origjinali ose origjinal (Fushëveprimi duhet të jetë ndërtimaria), leshuar nga nje institucion i akredituar.". Për faktin se, neni 26 i RRPP Nr.001/2022 në paragrafin 6 përcakton se: "*Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse*". Nga aspekti krahasimor i nenit 70 në raport me nenin 69 të LPP-së, shihet qartë se çertifikatat për sigurimin e cilësisë nuk janë kërkesa sipas neneve 66.1, 68 dhe 69 të LPP-së, por janë kërkesa të tilla që aplikohen individualisht për secilin anëtar të grupit ashtu siç është parashikuar dhe përcaktuar me nenin 26.6 të RRPP nr. 001/2022. Prandaj siç e vërteton situata e lartcekur, në rastin konkret GOE i shpërblyer me kontratë nuk e ka përmbushur këtë kërkesë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe përcaktimit ligjor sipas nenit 26.6 të kësaj rregullore.

Krahas kësaj, nga ana tjetër kemi gjetur se GOE i shpallur fitues bazuar në dokumentacionin që e ka ofruar (DUD) nuk e ka plotësuar as kriterin e kapacitetit teknik lidhur me kërkesën për pajisjen "mjet ngritës me pirun" i cili klasifikohet si mjet i kategorisë i cili sipas zërave të kontratës merr pjesë/përdoret në qarkullim rrugor dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollimit teknik vjetor, sigurimit dhe të regjistrohet siç kërkohet me Ligjin Nr. 05/L-132 (shih nenin 76, etj) dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2018 për Regjistrimin e Mjeteve, dhe në këtë kontekst të dëshmohet me librezë të regjistrimit. Prandaj siç e vërteton situata e lartcekur, në rastin konkret GOE i shpërblyer me kontratë nuk e ka përmbushur këtë kërkesë konform kërkesës së dosjes së tenderit si dhe kërkesave ligjore për mjetet që duhet t'i nënshtrohen kontrollimit teknik dhe regjistrimit sipas rregullativës ligjore të cekur më lart.

Në kontekstin e rrethanave të theksuara si më sipër, rezulton se tenderi/oferta e GOE të shpërblyer me kontratë nuk është në pajtueshmëri ose përputhshmëri me të gjitha kërkesat kualifikuese të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, si kusht qenësor i përcaktuar me nenin 59.4 të LPP-së dhe nenin 40 par.6 të RRPP. Prandaj, kjo situatë vërteton se në raport me GOE fitues vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në përputhje me nenin 59.4

lidhur me nenin 69 dhe nenin 60 par.1.2 të LPP-së si dhe nenin 40 par. 1,6 dhe 13 të RRPP Nr.001/2022. Në këtë kuptim ky OE është i papërgjegjshëm, respektivisht nuk mund ta dëshmojë statusin e palës me interes në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP

Pretendimi lidhur me OE "K.N.PSH. Papenburg & Adriany Company"

Në bazë të arsyetimit të paraqitur në Letrën standarde OE "K.N.PSH. Papenburg & Adriany Company", është vlerësuar si tenderues i pasuksesshëm për LOT 6.

Mirëpo duke u bazuar në analizimin e hollësishëm të dosjes dhe dokumenteve me të cilat OE në fjalë ka ofertuar në këtë aktivitet për lotin e lartcekur, e të cilat i kemi siguruar nga qasja zyrtare (formë elektronike) në dosjen e tij, kemi gjetur se tenderi/oferta e tij nuk është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat kualifikuese të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, i cili është kusht qenësor që përcakton se, tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit. Konkretisht nuk e ka plotësuar kriterin e kapacitetit teknik lidhur me kërkesën për pajisjen "mjet ngritës me pirun" i cili sipas zërave të kontratës merr pjesë/përdoret në qarkullim rrugor dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollimit teknik vjetor, sigurimit dhe të regjistrohet siç kërkohet me Ligjin Nr. 05/L-132 (shih nenin 76, etj) dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2018 për Regjistrimin e Mjeteve, dhe në këtë kontekst të dëshmohet me librezë të regjistrimit. Prandaj siç e vërteton situata e lartcekur, në rastin konkret OE i shpërblyer me kontratë nuk e ka përmbushur këtë kërkesë konform kërkesës së dosjes së tenderit si dhe kërkesave ligjore për mjetet që duhet t'i nënshtrohen kontrollimit teknik dhe regjistrimit sipas rregullativës ligjore të cekur më lart. Kjo situatë e dëshmon se nga ana e OE të lartcekur nuk është plotësuar kjo kërkesë konform kriterit/kërkesës të përcaktuar në DT dhe sipas bazës ligjore të zbatueshme në rastin konkret.

Në kontekstin e lartcekur rezulton se vlerësimi i ofertës/tenderit të OE të lartcekur nuk është bërë në përputhje me kërkesat e DT dhe as në përputhje me dispozitat përkatëse të LPP-së, konkretisht nenit 59.4 të këtij ligji dhe nenit 40.6 të RRPP. Në këtë kuptim ky OE është i papërgjegjshëm, respektivisht nuk mund ta dëshmojë statusin e palës me interes në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së.

Shtojcë: *GOE nuk mund të klasifikohet si palë me interes material në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP për shkak se është pajtuar me vendimin dhe me vlerësimin e tenderit për eliminimin e tij për këtë aktivitet të prokurimit.*

Pretendimi i lidhur me "GOE "Rexha & Qëndresa Sh.p.k."

Në bazë të arsyetimit të paraqitur në Letrën standarde "GOE "Rexha & Qëndresa Sh.p.k.", është vlerësuar si tenderues i pasuksesshëm për LOT 6.

Mirëpo duke u bazuar në analizimin e hollësishëm të dosjes dhe dokumenteve me të cilat GOE në fjalë ka ofertuar në këtë aktivitet për lotin e lartcekur, e të cilat i kemi

siguruar nga qasja zyrtare (formë elektronike) në dosjen e tij, kemi gjetur se tenderi/oferta e tij nuk është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat kualifikuese të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, i cili është kusht qenësor që përcakton se, tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit. Konkretisht nuk e ka plotësuar kriterin e kapacitetit teknik lidhur me kërkesën për pajisjen "mjet ngritës me pirun" për faktin se nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për këtë pajisje dhe se në kontekstin ligjor mungesa e dokumentacionit të kërkuar bën që OE të mos përmbushë kërkesat e dosjes së tenderit.

Në kontekstin e lartcekur rezulton se vlerësimi i ofertës/tenderit të GOE të lartcekur nuk është bërë në përputhje me kërkesat e DT dhe as në përputhje me dispozitat përkatëse të LPP-së, konkretisht nenit 59.4 të këtij ligji dhe nenit 40.6 të RRPP. Në këtë kuptim ky OE është i papërgjegjshëm, respektivisht nuk mund ta dëshmojë statusin e palës me interes në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së.

Shtojcë: *GOE nuk mund të klasifikohet si palë me interes material në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP për shkak se është pajtuar me vendimin dhe me vlerësimin e tenderit për eliminimin e tij për këtë aktivitet të prokurimit.*

Pretendimi lidhur me GOE "Agim Morina B.I. & Arbër1-NS Sh.p.k."

Në bazë të arsyetimit të paraqitur në Letrën standarde GOE "Agim Morina B.I. & Arbër1-NS Sh.p.k.", është vlerësuar si tenderues i pasuksesshëm për LOT 6.

